



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 8, datë 14.01.2021

**PËR NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE
FIGURËS TË MAGJISTRATIT ZNJ. SONILA MUHAMETAJ (DOMI), KANDIDAT
PËR T’U KOMANDUAR INSPEKTOR PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 2 germa “a”, 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 32, 35, 53, pika 3 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 10, Kreun IX, Seksioni A, pika 22, germa “b”, Kreun IX, Seksioni B, pika 12 germa “b”, Kreun IX, Seksioni C, pika 7, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “ Për ndërprerjen e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të magjistratit, kandidat për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Sonila Muhametaj (Domi)”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:


1. Të ndërpresë procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. Sonila Muhametaj (Domi), sipas relacion bashkëlidhur.
2. Ndalimin e vijimit të procedurës të komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të kandidatit prokuror, znj. Sonila Muhametaj (Domi).
3. Të njoftohet për këtë vendim znj. Sonila Muhametaj (Domi).
4. Ndaj vendimit të Këshillit për ndalimin e kandidimit, kandidati znj. Sonila Muhametaj (Domi), mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



Z. Kundër

ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
VATË STAKAJ



ANËTAR
TARTAR BAZAJ



ANËTAR
ESMERALDA KESHI

